



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court
Adresa: Perandori Justinian, PN. Prishtinë
T: +381 (0)38 220 104; F: +381 (0)38 220 112; www.gjk-ks.org

Prishtinë, datë: 24 mars 2010
Ref. Nr.: TK 10/10

VENDIMI PËR HEQJEN NGA LISTA TË KËRKESËS

Lënda Nr. KI. 12/09

Mehdi Krasniqi
vs
Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë prej:

Enver Hasani, Kryetar
Snezhana Botusharova, Gjyqtare
Robert Carolan, Gjyqtar
Ivan Čukalović, Gjyqtar
Iliriana Islami, Gjyqtar
Kadri Kryeziu, Gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, Gjyqtar
Almiro Rodrigues, Gjyqtar dhe
Altay Suroy, Gjyqtar

Parashtruesi i Kërkesës

1. Parashtruesi i Kërkesës është Mehdi Krasniqi, me vendbanim në Prishtinë.

Objekti i Shqyrtimit

2. Parashtruesi i kërkesës paraqiti një Kërkesë në Gjykatën Kushtetuese me 16 mars 2009. Në kërkesën e tij, Parashtruesi ankohet se e drejta e tij për pension invalidor (paaftësi për punë) është shkelur.

Bazat juridike

3. Neni 113 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës(më tej si: Kushtetuta), Neni 20 i Ligjit Nr.03/L-121 mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës(më tej si: Ligji), dhe Neni 32 i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese së Republikës së Kosovës(më tej si: Rregullorja e Punës).

Përmbledhja e fakteve

4. Parashtruesi i Kërkesës paraqiti një kërkesë për pension paaftësie për punë(invalidor) në Ministrinë e Punës dhe të Mirëqenies Sociale.

5. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale hodhi poshtë kërkesën e Parashtruesit me Vendimin Nr. 5000956. Parashtruesi apeloj kundër këtij Vendimi brenda afatit kohor të parashikuar prej 14 ditësh.

6. Me 15 nëntor 2007, Komisioni i Ankesave/Parashtresave, i cili vepron si organ i shkallës së dytë, hodhi poshtë ankesën e paraqitur nga Parashtruesi. Komisioni i Ankesave/Parashtresave argumentoi se Parashtruesi i ankesës ka dështuar të paraqesë evidencë relevante për të provuar ankesën e tij dhe si pasojë ankesa e tij u hodh poshtë si e pabazë.

7. Megjithatë, me 15 maj 2009, kërkesa e Parashtruesit për pension invalidor-(paaftësi për punë) u lejua si e suksesshme nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Përmbledhja e procedurës në Gjykatën Kushtetuese

8. Parashtruesi dorëzoi Kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese me 16 mars 2009.

9. Me 23 dhjetor 2009, Parashtruesi i Kërkesës njoftoi Gjykatën Kushtetuese se Kërkesa e tij për pension invalidor ka qenë e suksesshme nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Ai i ka bashkangjitur një kopje të Vendimit të datës 15 maj 2009 lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale parashtresës së tij dhe informoi Gjykatën se kërkesa e tij është plotësuar.

Vlerësimi i Gjykatës

10. Në mënyrë që të vendosim lidhur me kërkesën e Parashtruesit për të mos vazhduar më me rastin e Tij, Gjykata Kushtetuese duhet fillimisht të ekzaminojë nëse kushtet e parashikuara në rregulloren e Punës janë plotësuar.

11. Neni 32 i Rregullores së Punës, në pjesën përkatëse parasheh për sa vijon:

“Tërheqja e Kërkesës

(1) Pala e cila e ka parashtruar kërkesën mund ta tërheq atë në çfarëdo kohe para fillimit të seancës dëgjimore për atë kërkesë.

(2) Pavarësisht tërheqjes në pajtim me paragrafin (1), Gjykata mund të zgjedh të vendos në lidhje me atë kërkesë. Në rast të tillë, Gjykata vendos pa seancë dëgjimore, duke u bazuar vetëm në atë kërkesë dhe përgjigje, në rast se përgjigja është parashtruar, dhe çfarëdo dokumentesh të bashkëngjitura asaj...”

12. Me 18 shkurt 2010, bazuar në zhvillimet e mësipërme, Gjyqtari Raportues, Iliriana Islami, i rekomandoi Kolegjit Shqyrtues, i përbërë prej Gjyqtarëve Robert Carolan, (Kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalovič, të ndërpresin ekzaminimin e mëtejshëm të Kërkesës. Pasi rekomandimit të Gjyqtarit Raportues, Kolegji Shqyrtues u pajtua se nuk ka rrethana të jashtëzakonshme lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut, të cilat kërkojnë ekzaminim të mëtejshëm të Kërkesës dhe në të njëjtën datë i përcolli Gjykatës Rekomandimin e tyre.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, sipas Nenit 20 të Ligjit dhe Nenit 32 të Rregullores së Punës, në mënyrë unanime,

VENDOS

I. Heqjen e Kërkesës nga lista.

II. Ky Vendim do t’ju njoftohet Palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me Nenin 20.4 të Ligjit.

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar Raportues

Prof. Dr. Iliriana Islami

Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani

